



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 07 dhjetor 2015, në mbledhjen e gjashtë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.10

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Nexhmi Rudari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Sami Ajeti, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Nivel komunal; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z. Faik Muçiqi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim; z. Bunjamin Hoti, përfaqësues i OJQ-ve; z. Fadil Halimi, përfaqësues i Mediave lokale; z. Avni Shabani, përfaqësues i Komunitetit të biznesit dhe z. Idriz Hoxha, përfaqësues i komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi: z. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame dhe z. Sabedin Rama, përfaqësues i Komunitetit rom.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës; përfaqësuesi i KFOR-it; z. Joakim Frendin dhe z. Bekim Karaxhija – OSBE; përfaqësuesë të Zyrës së UNMIK-ut.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, ju përshëndes të gjithëve, mirë se keni ardhur, më lejoni të hapi mbledhjen e gjashtë të KKS-së. Rendin e punës sigurisht e keni marrë me kohë, por besoj me një koordinim më të mirë është dashur që materialet për temat përkatëse tu dorëzohen paraprakisht, si bazë për diskutim. Nëse jeni dakord mund të fillojmë me këtë rend pune.

1. Rend i propozuar i ditës

U miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29 shtator 2015.

U miratua njëzëri

3. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Bekim Bislimi.

z. Bekim Bislimi, theksoi, sa i përket situatës së sigurisë në rajonin tonë të përgjegjësisë, ajo është e qetë në përgjithësi. Për këtë bazohemi në të dhënat statistikore që disponojmë. Unë kam përgatitur një raport të njëmbëdhjet muorit të vitit 2014 krahasuar me vitin 2015. Numri i rasteve të raportuara në

vitin 2014 ishte 1523, ndërsa 1017 në vitin 2015, që rezulton me 508 raste më pak apo shprehur në përqindje 40.60% më pak.

Te kategoria e veprave penale vjedhjet kemi rënie, nga 283 në 162 raste ndërsa te vjedhjet e rënda nga 278 në 120 raste. Gjatë kësaj periudhe kemi asistuar në punët dhe aktivitetet e Institucioneve qendrore dhe komunale dhe të organizatave qeveritare dhe jo qeveritare. Gjithashtu jemi angazhuar në zbatimin e planeve operative si, parandalimin e të shtënave me armë në dasma, inspektimin e lokaleve për respektimin e orarit të punës dhe prishjen e rendit dhe qetësisë publike, parandalimin e transportit ilegal të druve i cili vazhdon ende.

Gjatë periudhës raportuese kemi konfiskuar 76 armë, 778 municione, 70 persona të ndaluar në Qendrën e mbajtjes. Kemi procedur fletëparaqitje te inspeksioni komunal për inicimin e procedurave përkatëse ndaj subjekteve afariste për mos respektimin e orarit të punës si dhe fletëparaqitje në gjykatë për rastet e prishjes së rendit dhe qetësisë publike.

Në kuadër të bashkëpunimit me popullatën kemi mbajtur takime me dy KLSP-të në fshatrat Kërpimëh dhe Orllan.

Kemi realizuar projektin e ligjërimit dy javor në shkollat fillore dhe të mesme me temat; siguria në rrugë, dhuna në familje, trafikimi me qenie njerëzore dhe droga është zero jeta është një, e gjithë kjo për vetëdijesimin e nxënësve për rrezikun dhe pasojat nga përdorimi i substancave narkotike.

Si rezultat i bashkëpunimit me institucionet arsimore deri më tani nuk kemi ndonjë incident të ndjeshëm të raportuar në shkolla.

Nga qytetarët kemi pranuar ankesa për shkak të rrezikut nga qentë endacak, mirëpo jemi të kufizuar në këtë drejtim duke respektuar Ligjin për mbrojtjen e kafshëve, mirëpo në të ardhmen mendoj se kjo çështje do të rregullohet nga institucionet relevante, në mënyrë që mos të pësojnë qytetarët.

Gjendja e sigurisë në Komunë është rezultat i punës së Policisë dhe i bashkëpunimit dhe përkrahjes nga ana e Kryetarit të Komunës, Bashkësisë Islame, organizatave qeveritare dhe joqeveritare, mediave, KFOR-it dhe natyrisht popullatës, mirëpo ne do të vazhdojmë të punojmë të sigurojmë një ambient edhe më të qetë në të ardhmen. Nuk kam diçka tjetër për të shtuar, nëse keni ndonjë pyetje jam i gatshëm të përgjigjem.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën e ka përfaqësuesi i KFOR-it.

Përfaqësuesi i KFOR-it, ju faleminderit, sa i përket gjendjes së sigurisë, Komuna e Podujevës konsiderohet shembull, por edhe sa i përket bashkëpunimit me institucionet relevante i cili bashkëpunim do të vazhdoj edhe në të ardhmen.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, unë e hap diskutimin lidhur me këtë pikë, por paraprakisht dua të theksoj se jemi të kënaqur me situatën e sigurisë në Komunë. Është një prej Komunave më të qeta, më të sigurta, me tendencë të rënies së veprave të ndryshme. Ne e kemi vërejtur në bazë të raportimeve të rregullta që janë bërë nga Komandanti i Stacionit të Policisë, por edhe nga përfaqësuesit e KFOR-it, me konstatimet e tyre. Kjo është meritë e organeve përgjegjëse në radhë të parë por edhe të akterëve të tjerë. Ne do të vazhdojmë dhe do të bëjmë përpjekje që angazhimi ynë të jet në nivelin e duhur dhe unë pres që secili nga ju si anëtarë të Këshillit të jepni kontributin e juaj në mënyrë që kjo situatë të jet e qëndrueshme por edhe të përmirësohet në disa aspekte që këtu disa herë i kemi potencuar.

z. Faik Muçiqi, sa i përket sigurisë desha të potencojë një çështje që i referohet drunjtëve-plepave në qytet, që paraqesin rrezikshmëri për jetën dhe pronën e qytetarëve. Ne kemi bërë kërkesë në Agjencionin për Intervenime Emergjente, meqenëse Komuna nuk ka kapacitete për largimin e tyre. Plepat janë të lartë dhe janë afër institucioneve publike dhe shtëpive familjare. Ne ende nuk kemi marr përgjigje nga Agjencioni dhe nuk jemi në dijeni se deri ku ka arritur kërkesa, pasi që është një procedurë e stërzgatur e procedimit të kërkesës. Nga ky takim të jet si apel që këta plepa duhet të largohen.

Radisav Perović, theksoi, 10 ditë kemi mbetur pa energji elektrike, por pas intervenimeve kjo gjendje është rregulluar. Dua të theksoj se më datën 22 të muajit të kaluar isha në varrimin e një kushëriri tim dhe gjatë kalimit të kufirit policia ishte prezente dhe është sjellur shumë mirë, kështu që jam i kënaqur plotësisht.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, faleminderoj Komandantin e Stacionit të Policisë dhe përfaqësuesin e KFOR-it për raportimet e bëra, nëse dikush nuk ka diçka tjetër rreth kësaj teme kalojmë në pikën e radhës

4. Informatë për rastet e kthimit dhe integrimit të qytetarëve në shtëpitë (pronat) e tyre.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën e ka z. Liman Zeqiri.

z. Liman Zeqiri, faleminderit Kryetar, këtë temë e kam kuptuar për personat e riatdhesuar dhe ky është një proces mjaft kompleksiv. Unë do të sqaroj çështjen se çka nënkuptojmë me procesin e kthimit. Nëse bazohemi në Rregulloren QRK nr. 20/2013 për personat e riatdhesuar, kanë të drejtë të gjithë të riatdhesohen në vendin tonë por mbështetja nga ana e institucioneve kufizohet vetëm për personat që e kanë lëshuar vendin tonë deri më datën 28.07.2010, do të thotë pas kësaj date persona që e kanë lëshuar vendin dhe kanë migruar në vendet perëndimore, ata në bazë të kësaj Rregulloreje nuk kemi mundësi ti trajtojmë por vetëm vetëm ti udhëzojmë. Të gjithë personat që kthehen trajtohen në mënyrën më të mirë. Ne i marrim të gjitha informacionet nga MPB-ja posa të vijnë në aeroport dhe bëhet akomodimi i tyre. Zyra për Komunitete dhe Kthim i merr të gjitha të dhënat e tyre dhe pastaj çështja procedohet në Komisionin Komunal për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar për shqyrtim. Shefi i ZKKK në vazhdim foli për procedurat dhe trajtimin e rasteve nga Komisioni Qendror për Riintegrim. Nënvizoi, si trajtime hyn renovimi dhe ndërtimi i shtëpive, financimi dhe plani i biznesit, ngase një numër i tyre kanë edhe ide dhe biznese, kështu që normal ndihmohen edhe nga Komisioni Qendror por edhe nga Ministritë përkatëse, pastaj trajtimet mjekësore me medikamente dhe strehimet. Pra janë katër shtylla bazë që këto më shumë vendosen në Komisionin Qendror për Riintegrim, ndërsa Komisioni Komunal për Riintegrim i merr të gjitha të dhënat e atyre personave që kthehen te ne dhe ne i trajtojmë me ato ndihmat tona emergjente, siç janë pakoja ushqimore dhe mjete higjienike, pakoja me dru për ngrohje, pakoja e ndihmës për orendi dhe mjete tjera asistencë sociale, sigurimi i banimit përmes qirasë së tregut me bonuse, ndihmat sociale për raste që kanë nevojë. Ne i orientojmë në Qendrën për Punë Sociale dhe i ndihmojmë me rregullimin e dokumentacioneve dhe i udhëzojmë në shërbimet përkatëse. Të gjitha informacionet i marrin në Komunë dhe ne i vizitojmë në terren dhe kushtimisht theksoj se edhe pse ka të kthyer shumë dhe nuk lajmërohen shumica prej tyre i kanë banimet. Jemi në koordinim edhe me Qendrën për Punë Sociale dhe Zyrën e punësimit ku në bashkëpunim me UNDP kanë edhe trajnime dhe shumë prej tyre kanë edhe zanate dhe që janë të aftësuar dhe ndërmarrjet e mëdha kur kërkojnë punëtorë ne i udhëzojmë ku të shkojnë qoftë në ndërtimtari, sanitari, elektro etj. Në kuptim të kësaj ne asnjëherë nuk kemi pasur ndonjë problem dhe falë angazhimit dhe punës tonë dhe unë publikisht e falënderoj zyrtarin për integritet evropiane z. Ylber Salihu për punën e madhe në këtë fushë ngase është një punë voluminoze që ndërlidhet edhe me aktivitete në terren që normalisht arrijmë qëllimin.

Në qoftëse i referohemi kësaj pune për këtë vit ne i kemi vetëm 4 raste, njëri prej tyre është i interesuar për themelimin e biznesit të tij dhe në bazë të planit të biznesit dhe preferencave që i gëzon, përfshirë edhe ndihmën tonë atëherë Niveli Qendrorë i merr këto përbazë dhe i ndihmojnë, e që i kanë ndihmuar edhe vitet e kaluara, ndërsa ndaj tre personave të tjerë është duke vazhduar vazhdimi i ofrimit të strehimit, në periudhë gjashtë muaj plus gjashtë muaj dhe këtë shpenzim e ka përsipër MPB, ndërsa ne si komision e kemi për detyrë t'ua gjejmë vendbanimin.

Çështje tjetër është rexhistri i personave të kthyer të cilët kanë migruar gjatë fundvitit 2014 dhe fillimi i vitit 2015, ku ishte një valë jashtëzakonisht e madhe, ku kanë migruar një numër i qytetarëve edhe pse i kemi dhënë të gjitha informacionet tona dhe udhëzimet se nuk ka azil, ku dihet se pas vitit 2008 është problematikë për të zgjedhur statusin e azilkërkuesit, por mjerisht qytetarë për qëllime të veta apo përmes formave të kontrabandimit një numër i madhë i njerëzve ka shkuar në botën e jashtme dhe një numër të konsideruar të tyre, në procedurë të përshpejtuar i kanë kthyer. Nëse i referohemi kësaj liste të të kthyerve numri është 126 familje apo në total 331 persona që janë kthyer e që janë lajmëruar, por ka edhe

shumë familje që nuk lajmërohen. Ne u tregojmë të gjitha mundësitë dhe kriteret nga rregullorja e cekur dhe këta persona nuk kanë mundësi të përfitojnë, ngase kjo kategori nuk i plotëson kushtet dhe kriteret që të ndihmohet. Pavarësisht nga kjo ne i evidentojmë të gjitha të dhënat e tyre dhe duke vlerësuar gjendjen ekonomike dhe sociale ne si komision por edhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kemi arritur sadopak të ndihmojmë dhe të zbusim gjendjen e tyre sociale. Kjo ishte e tëra, nëse ka dikush diçka, jam në dispozicion të përgjigjem.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, falënderojmë shefin e ZKKK për këtë informatë të mirë, nëse ka dikush diçka në lidhje me këtë çështje mund ta marr fjalën.

Kryetari shprehu interesimin për fëmijët e të kthyerve rreth vijimit të shkollës.

z. Liman Zeqiri, sa i përket fëmijëve të rikthyer për vijimin e shkollimit kjo çështje është rregulluar në atë mënyrë, poqese fëmija nuk posedon ndonjë dokument se ka vazhduar shkollimin në vendin e migrimit ku ka jetuar dhe kthehet ai nuk mund ta vazhdoj mësimin në klasën që mendon fjala vjen ka qenë në klasë të katërt e duhet të vazhdoj në të pestën por duhet të kthehet në klasën e katërt aty ku ka ndërprerë. Është për keqardhje por ka raste kur u ka humbur viti dhe duhet përsëritur. Kjo është përcaktuar me Udhëzim Administrativ.

z. Avni Maloku, unë vetëm desha të ndërlidhem me diskutimin e parafolësit, në çështjen e vazhdimit të shkollimit të nxënësve të riatdhesuar. Sa për informim është një Udhëzimin Administrativ i MASHT-it që e rregullon këtë çështje dhe për këtë janë të nformuara institucionet shkollore.

z. Liman Zeqiri, dua të theksoj se kjo çështje u diskutuar edhe në Komitetin për Komunitete ku edhe është sqaruar përmbajtja e Udhëzimit Administrim që i referohet rregullimit të kësaj çështjeje.

Shefi i ZKKK foli për një rast konkret në të cilin është zbatuar kjo rregullativë.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, nga ky takim u bëjmë thirrje të gjithë atyre në botën e jashtme, që janë duke qëndruar kot të kthehen në pronat e tyre, në shtëpitë e tyre, ti kthejnë fëmijët në shkollë, ngase ne e dimë se disa prej tyre kanë lënë pronat dhe shtëpitë, e ka të atillë që i kanë lënë edhe vendet e punës, e për ato raste që nuk e kanë të rregulluar çështjen e strehimit, të banimit ne me atë buxhet që është i përcaktuar në përgjegjësi të Ministrisë i sigurojmë edhe strehim dhe nuk kanë arsye ata të paraqesin fakte të rrejshme për ta fituar të drejtën e qëndrimit në botën e jashtme, sikurse ka ndonjë rast që bënë përpjekje për të treguar se është i rrezikuar apo për çështjen e sigurisë, pra ne u bëjmë thirrje të kthehen në pronat e tyre dhe të koontribojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

z. Shaban Ahmeti, theksoi, të gjithë pjesëtarët e Komunitetit ashkali që kanë migruar në botën e jashtme, këtë e kanë bërë me qëllimin e vetëm, për një jetë më të mirë e nuk ka kurrfarë arsyes politike.

Radisav Perović, desha të shtoj diçka lidhur me personat e riatdhesuar. Unë kam një fqinjë, po kërkoj këshillë nga ju, cilat janë mundësitë që ajo familje të kthehet në shtëpinë dhe pronën e tyre, që i kanë të gjitha, pasi që atje ku kanë shkuar jetojnë në një gjendje të rëndë sociale, pra a mund të kthehen. Kërkoj nëse është e mundur të më ndihmoni që tu them që të kthehen lirisht. Ata e kanë braktisur shtëpinë brenda një kohe të shkurtër ka 7,8 apo 10 vite , e jo para 50 viteve. Deri tani nuk kam mundur që këtë ta paraqes edhe pse më kanë pyetur disa herë pasi që ata janë në dijeni se unë marr pjesë në këto takimeve, por nuk mundem t'iu premtoj asgjë.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, ne iu bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve të Komunës të kthehen në pronat dhe shtëpitë e tyre, kush ka vullnet dhe mundësi pa dallim përkatësie.

Nëse dikush nuk ka diçka rreth kësaj teme kalojmë në pikën e radhës.

5.Ngritja e grupeve punuese për:

-Përgatitjen e propozimit të Planit të punës për vitin 2016

-Përgatitjen e Informatës për aktivitetet e KKS-së në vitin 2015

Kryesuesi pas aprovimit të propozimeve konfirmoi ngritjen e Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës për vitin 2016 dhe Informatën për aktivitetet e KKSB-së në vitin 2015, në përbërje:

1. Faik Muçiqi
2. Bekim Bislimi
3. Bekim Jashari
4. Naime Podvorica
5. Shaban Ahmeti

6. Të ndryshme

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, a ka dikush diçka në pikën të ndryshme.

z. Benjamin Hoti, desha të bëj një përshkrim të shkurtër të gjendjes aktuale të Shoqërisë civile në Komunën e Podujevës. Ekzistojnë mbi 120 organizata të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike të cilat si vend të veprimit kanë Komunën e Podujevës.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, nëse nuk ka diçka urgjente që duhet diskutuar në lidhje me temën e shtruar nga parafolësi, këtë mund ta parashohim si pikë të veçantë në njërën nga mbledhjet e ardhshme, të përgatitet materiali përkatës në formë të informatës për diskutim, pa ndonjë qëllim të ndërhyrjes në punën dhe veprimtarinë e tyre.

Anëtarët e Këshillit njëzëri u dakorduan me propozimin e Kryetarit që tema e theksuar për shoqërinë civile të procedohet në mbledhjen e radhës, me materialin përkatës.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, desha të shfrytëzoj rastin që përmes z. Naim Bajraktarit të falënderoj Forcën e Sigurisë së Kosovës në përgjithësi, në veçanti Njësinë e Gjendjes për bashkëpunim të mirë që kemi kohën e fundit pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes Kryetarit të Komunës dhe FSK-së, për rregullimin, gjegjësisht mbushjen e hapësirave të objekti i shkollës së re në fshatin Batllavë. Ka qenë një bashkëpunim i mirë, projekti është kryer sikurse e kemi dizajnuar.

Kryetari përfundoi mbledhjen pasi që nuk pat çështje tjera për shqyrtim, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 10.55

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. 02-006-105617

Podujevë,

07 dhjetor 2015

Kryetari i Komunës

Agim Veliu